

SEKSIONI I KATËRT
VENDIM MBI PRANUESHMËRINË

ANKIMI NR.24096/05
NGA VEFA HOLDING SHPK DHE ALIMUÇAJ
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në cilësinë e një dhome të përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,

Lech Garlicki

Ljiljana Mijović

Ján Šikuta

Päivi Hirvelä

Zdravka Kalaydjieva

Nebojša Vučinić, gjyqtarë

and Fatoş Aracı, zëvendësregjistrues i seksionit,

Duke pasur parasysh ankimin e mësipërm depozituar më 2 qershor 2005,

Duke pasur parasysh vëzhgimet e parashtruara nga Qeveria e paditur dhe vëzhgimet,

në përgjigje të parashtruara nga ankuesit,

Pas shqyrtimit, vendosi si më poshtë:

FAKTET

1. Shoqëria ankuese, “Vefa Holding sh.p.k.”, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktualisht në administrim të kufizuar, me zyrë të regjistruar në Tiranë, Shqipëri. Ankimi është paraqitur në emër të saj nga z.Vehbi Alimuçaj, një shtetas shqiptar, i cili ka lindur në vitin 1949 dhe vuan dënimin me burgim në burgun e Peqinit (ankuesi individual). z.Alimuçaj ishte presidenti i shoqërisë ankuese dhe aksionari i vetëm i saj deri kur ajo u vendos në administrim të detyruar.

2. Ankuesit u përfaqësuan para Gjykatës nga z. Sh. Dizdari, avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. E. Hajro nga Avokatura e Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Faktet e çështjes, siç u parashtruan nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë vijon.

4. Ankuesi individual ishte pronari i shoqërisë ankuese, e cila fillimisht u krijua si një shoqëri tregtare më 28 gusht 1992. Objekti i aktivitetit të saj u zgjerua në mënyrë progresive me kalimin e viteve, si rezultat i së cilës ajo ndryshoi emrin e saj të regjistruar dhe objektin e aktivitetit respektivisht më 14 dhjetor 1993, 10 dhjetor 1994 dhe 3 shkurt 1997, duke u njohur dhe regjistruar përfundimisht si “Vefa Holding sh.p.k.”. Për shkak të pavullnetshmërisë së bankave tregtare për të siguruar burime financiare për zgjerimin e saj, shoqëria ankuese hyri në kontrata huaje me individë. Dukej se nga viti 1994 deri në vitin 1997 shoqëria ankuese vazhdoi të merrte para hua me qëllim që të vazhdonte me planet e saj të investimit.

5. Në vitin 1997 Shqipëria u godit nga një trazirë civile në shkallë të gjerë, e cila u nxit nga rënia e të ashtuquajturave skema piramidale të cilat ishin krijuar gjatë viteve të mëparshme.

B. Procedurat e administrimit të detyruar

6. Shteti ndërhyri për të rivendosur rendin publik dhe miratoi legjislacionin.

7. Më 23 janar 1997 hyri në fuqi ligji i ndalimit të skemave piramidale (shih më poshtë “E drejta dhe praktika përkatëse vendase”). Ligji nuk lejoi që dy ankuesit të vazhdonin të hynin në kontratë huaje me individë për të ndjekur investimet e shoqërisë.

8. Më 9 maj 1997 hyri në fuqi ligji për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji nr.1). Ligji nr.1 pësoi një sërë ndryshimesh siç paraqiten në nenin më poshtë “E drejta dhe praktika përkatëse vendase”.

9. Më 22 gusht 1997 Qeveria vendosi që shoqëria ankuese t’i nënshtrohej një kontrolli financiar sipas nenit 5 të ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji nr.2). Prandaj ajo caktoi tre administratorë shqiptarë. Vendimi nuk përmendi asnjë argument të veçantë ligjor referuar në nenin 5, në të cilin u bazua Qeveria.

10. Në një datë të pacaktuar në vitin 1997 shoqëria ankuese apeloj kundër vendimit të Qeverisë të datës

22 gusht 1997 në Gjykatën e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit).

11. Më 17 shtator 1997, Gjykata e Apelit prishi vendimin dhe urdhëroi pezullimin e masës së administrimit të detyruar. Ajo konstatoi se nuk ekzistonte asnjë interes publik për caktimin e administratorëve.

12. Më 28 tetor 1997, Qeveria konfirmoi tre administratorët e njëjtë që kishte caktuar në vendimin e saj të mëparshëm të datës 22 gusht 1997, duke mos dhënë arsye të mtejshme sipas nenit 5 të ligjit nr.2.

13. Më 6 nëntor 1997, Qeveria lidhi kontratë për shërbimet me një shoqëri ndërkombëtare, “D”, e cila duhej të zëvendësonte tre administratorët individualë dhe të vepronte si një administrator i vetëm i shoqërisë ankuese. Sipas termave të përcaktuara, detyrat e D-së duhej të kryheshin në dy faza. Gjatë fazës së parë, *inter alia*, D-ja duhej të merrte kontrollin e shoqërisë ankuese, të ushtronte të gjitha kompetencat dhe të drejtat e caktuara në shoqëri, duke përfshirë kompetencën për të vazhduar biznesin e saj, për të paguar borxhet, për të ndërprerë aktivitetet, për të shitur asetet dhe për të mbajtur, pezulluar apo zëvendësuar stafin ose menaxherët. Do të përpilohej një inventar për asetet e shoqërisë ankuese dhe do të përgatitej një plan veprimi për rimëkëmbjen e aseteve. Do të kryhej një kontroll nga ekspertë kontabël cilësorë të cilët do të caktoheshin nga Qeveria. Gjatë fazës së dytë, D-ja do të zbatonte planin e veprimit për rimëkëmbjen e aseteve duke përfshirë shitjen e tyre, do të depozitonte të gjitha fitimet e rimëkëmbjes së aseteve pranë subjektit të caktuar nga Qeveria, do të asistonte në procesin e rishpërndarjes, do të bashkëpunonte në përgatitjen e një kontrolli financiar për situatën e mbylljes dhe do të përgatiste një raport përfundimtar për Qeverinë.

14. Në një datë të pacaktuar në vitin 1997, ankuesi individual kundërshtoi nenin 7 të ligjit nr.2 para Gjykatës Kushtetuese, meqenëse autorizonte administratorët ta zëvendësonin atë dhe të merrnin përsipër të gjitha të drejtat e pronës të cilat ishin *stricto sensu* të lidhura me pronësinë e tij të shoqërisë ankuese.

15. Më 13 nëntor 1997, Gjykata Kushtetuese shpalli jokushtetues nenin 7 të ligjit nr.2. Ajo konstatoi se duke i caktuar administratorëve disa detyra, si ndërprerjen e detyrimeve kontraktuale, menaxhimin e aktiviteteve të biznesit dhe pronës së subjektit, ushtrimin e të drejtave të aksionarit dhe shitjen e pronës, i kishte hequr të gjitha të drejtat e pronës aksionarit të vetëm në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese. Meqenëse të drejta të tilla janë kompetencë vetëm e gjykatave vendase, kalimi i tyre tek administratorët kishte shkelur parimin kushtetues të ndarjes së kompetencave. Ajo argumentoi se neni 7 i ligjit nr.2 ishte në kundërshtim me nenin 3 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese.

16. Më 19 nëntor 1997 u plotësua neni 10 i ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese duke përfshirë të drejtën e shtetit për të kontrolluar dhe administruar pronën e subjekteve private siç është shoqëria ankuese. Si rezultat, po atë ditë, Parlamenti miratoi ndryshimin e ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji nr.3), duke rifutur formulimin e nenit 7 të mëparshëm jokushtetues të ligjit nr.2.

17. Më 24 nëntor 1997, Qeveria prishi vendimin e saj të datës 28 nëntor 1997 (shih paragrafin 12 më lart). Ajo përsëriti masën e administrimit të detyruar në lidhje me shoqërinë ankuese dhe caktoi D-në si administrator.

18. Më 31 janar 1998, D-ja i paraqiti Qeverisë raportin e saj të parë. Raportit iu shtuan tabelat e vlerësimit për asetet kryesore, rikthimet e planifikuara nga shitjet dhe pasqyrat financiare. Përmbledhja ekzekutive e raportit përmbante një paragraf me shkronja të zeza, i cili deklaronte (marrë nga versioni origjinal në anglisht):

“Rekomandimi i administratorëve është që të shiten asetet e shoqërisë. Kjo duhet bërë në mënyrën më të duhur për t’i siguruar kreditorëve rikthimin më të mirë brenda një periudhe kohore të arsyeshme”.

19. Më tej, raporti deklaronte se shoqëria ankuese kishte qenë një biznes i larmishëm i përbërë prej më shumë se 200 aktiviteteve në Shqipëri dhe aktivitete me kapital të përbashkët, si dhe agjenci në të paktën tetë vende të tjera. Shumë nga aktivitetet e saj ishin dëmtuar gjatë trazirave civile në pranverën e vitit 1997. Në përgatitjen e raportit nuk është kryer asnjë kontroll financiar i shoqërisë ankuese meqenëse nuk ishte pjesë e mandatit të tyre. D-ja deklaroi se informacioni financiar që u ishte siguruar atyre nga shoqëria apo palë të treta, duke përfshirë agjenci të ndryshme qeveritare, shpesh ishte i pasigurt dhe i paplotë për shkak të shkatërrimit të dokumenteve dhe regjistrave gjatë revoltave, zhdukjes së pretenduar të librave dhe regjistrave të shoqërisë, refuzimit të disa palëve për të dhënë informacione përkatëse ose, kur kërkohet për të dhënë shpjegime për informacione apo të dhëna të dyshimta, dhe, dështimit të disa palëve për të ruajtur librat dhe regjistrat e duhur. Përveç kësaj, disa prona që supozoheshin në pronësinë e shoqërisë ankuese nuk mund të gjendeshin; ishin zbuluar prona të paregjistruara, disa prona ishin “pushtuar” dhe, për prona të tjera, pronësia pretendohet nga palë të treta. Më tej, të dhënat mbi pretendimet e mbledhura të kreditorëve vinin nga librat dhe regjistrat e pronarëve të shoqërisë, dhe jo nga vetë kreditorët.

20. Sipas konstatimeve kryesore të datës 30 nëntor 1997 për pozicionin financiar të shoqërisë ankuese, *inter alia*, argumentohet se shoqëria ankuese nuk ka vepruar asnjëherë me përfitim, se në të ardhmen e afërt nuk do të kishte para, nuk ishte në gjendje të përmbushte detyrimet e saj dhe ishte e paaftë të paguante, bilanci i saj nuk pasqyronte fondet e marra nga kreditorët dhe librat dhe regjistrat e saj nuk përputheshin me njëri-tjetrin. Strategjia e propozuar për të rritur në maksimum rimëkëmbjen për kreditorët ishte shitja e aseteve të shoqërisë ankuese.

21. Më 6 mars 1998 Qeveria vendosi të kryejë një kontroll financiar të shoqërisë ankuese dhe caktoi pesë ekspertë kontabilistë individualë.

22. Më 25 mars 1998, Ministri i Financave ndryshoi termet e përcaktuar të kontratës që ishte përfunduar ndërmjet Qeverisë dhe administratorëve, D, sipas së cilës administratorët “do të bënin çdo përpjekje për të kthyer sa më shumë asete dhe biznese të fondeve për të likuiduar përpara datës 31 dhjetor 1998”. Kjo shënoi fillimin e fazës së dytë të shërbimeve të administratorëve.

23. Më 24 qershor 1998 Qeveria caktoi shoqërinë B si eksperte kontabiliste përveç ekspertëve kontabilistë individualë të caktuar me 6 mars 1998. Rrjedhimisht, më 5 janar 1999 B-ja paraqiti një raport. Sipas raportit, kishte qenë e pamundur për të përfutur ndonjë dokument deri më datën 28 korrik 1998. Për shkak të kësaj vonese, koha e kufizuar në dispozicion nuk lejonte B-në të kryente dhe plotësonte kontrollin financiar të shoqërisë.

24. Kontrolli financiar i shoqërisë ankuese duhej të bazohej vetëm në dokumentet e paraqitura nga grupi i mbikëqyrësve dhe administratorët, D, dhe duhej të përfundohej deri më 31 dhjetor 1998. Përpara vitit 1996 nuk është marrë asnjë dokument apo e dhënë financiare për shoqërinë meqenëse ishin shkatërruar gjatë revoltave në mars 1997. Përveç kësaj, nuk lejohej shqyrtimi i dokumenteve që ishin mbajtur nga prokuroria gjatë procedimeve kundër ankuesit individual, duke përfshirë dhjetë terminale kompjuterike. Prandaj, sipas raportit, rrjedhja e fondeve të siguruara nuk përfaqësonte saktësisht rrjedhjen aktuale të fondeve të shoqërisë, meqenëse “saktësia absolute, ndonëse e dëshirueshme, nuk mund të arrihej (dhe nuk do të arrihet) duke pasur parasysh informacionin në dispozicion”.

25. Raporti siguron një përmbledhje të aktiviteteve vendase dhe ndërkombëtare, skemën organizative të saj dhe organizimin e sistemit të kontabilitetit dhe kontrollit financiar. Neni 4 përfshinte tabelën e rrjedhjes së fondeve. Raporti përfundonte duke deklaruar se “në fillimin e saj, dukej se shoqëria ishte angazhuar në biznes tregtar. Megjithatë pas marrjes së huave [drejt fundit të vitit 1994, në vitin 1995 dhe veçanërisht në vitin 1996], ajo filloi të shfaqte karakteristika të një skeme piramidale, në të cilën aktiviteti tregtar mori një rol dytësor në krahasim me depozitat. Në të vërtetë, niveli i të ardhurave nga aktivitetet tregtare nuk ishte dhe nuk mund të ishte i mjaftueshëm për të shlyer përqindjen e lartë të interesave dhe kapitalin e investuar nga depozituesit, pasi duhej të pranoheshin depozita të reja me qëllim që të shlyheshin depozituesit e mëparshëm”.

26. Më 30 korrik 1998 hyri në fuqi ligji për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë, mbi bazën e të cilit çdo pronë që i përkiste personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë do të nxirreshin në shitje nga administratorët brenda të njëjtit vit. Për rrjedhojë, u shitën asetet dhe pasuritë e shoqërisë ankuese.

27. Më 28 nëntor 1998, hyri në fuqi Kushtetuta e Shqipërisë. Në një datë të pacaktuar, shoqëria ankuese, duke u bazuar në Kushtetutë, i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të shpallte jokushtetues ligjin për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë dhe ligjin për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë. Më 17 janar 1999, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për arsye se nuk ishte në përputhje me nenin 131 (f) dhe 134 të Kushtetutës, me sa duket për mungesë legjitimitimi (shih më poshtë “E drejta vendase përkatëse”).

28. Në një datë të pacaktuar, ka shumë të ngjarë në vitin 1999, administratorët paraqitën një raport financiar që korrespondonte me përfundimin e fazës së dytë, e cila ishte përqendruar në shitjen e pasurive të shoqërisë ankuese. Raporti përmbante, gjithashtu, një deklaratë të faturave dhe pagesave, një përmbledhje të rrjedhjes së fondeve dhe një deklaratë në lidhje me vlerësimin e rezultatit të datës 31 mars 1999.

29. Më 17 mars 2003 Parlamenti krijoi një komision hetimor për të shqyrtuar transparencën e procesit për administrimin dhe shitjen e pasurive që, *inter alia*, i përkiste shoqërisë ankuese. Opinioni kundërshtues i anëtarëve të komisionit hetimor që arrinte në 145 faqe, ishte mjaft kritik për të gjithë procesin, veçanërisht për

procedurën jashtëgjyqësore të falimentimit që ishte ndjekur nga Qeveria.

30. Më 22 nëntor 2007 grupi i mbikëqyrësve njoftoi shoqërinë ankuese se procesi vazhdonte akoma dhe se asnjë vendim gjykate nuk ishte marrë akoma për të shpallur shoqërinë të falimentuar.

31. Më 29 mars 2010 grupi i mbikëqyrësve i dërgoi një letër Avokaturës së Shtetit. Sipas letrës shoqëria ankuese ishte certifikuar si një shoqëri që vepronte sipas një skeme piramidale në bazë të raportit të administratorëve. Me vendim të Këshillit të Ministrave koeficienti i shlyerjes për shoqërinë ankuese u përcaktua në masën njëmbëdhjetë për qind. Detyrimi debitor i shoqërisë ankuese arrinte në 34,361,781,170 lekë shqiptarë, që i detyrohej 73,509 kreditorëve në total. 57,742 kreditorë kishin përfituar nga shlyerja dhe procesi i likuidimit vazhdonte për pjesën tjetër 15,757, për një shumë totale prej 440,550,176 lekësh shqiptarë. Raporti përfundonte se po bëheshin përpjekje për riatdhesimin në Shqipëri të një numri depozitash të zbuluara në vende të huaja. Administrimi i detyruar i shoqërisë ankuese vazhdoi në përputhje me ligjet dhe nënligjet në fuqi.

C. Procedimet penale ndaj ankuesit individual

32. Më 12 prill 1998 administratorët kërkuan që ankuesi individual të ndiqej penalisht për mashtrim. Më 28 prill 1998 prokurori akuzoi ankuesin individual për mashtrim. Ankuesi individual u arrestua po atë ditë.

33. Më 10 mars 1999 prokurori vendosi të caktonte tre ekspertë për të përgatitur një raport financiar kontabiliteti të shoqërisë ankuese.

34. Më 21 prill 1999 ekspertët paraqitën raportin e tyre, sipas të cilit numri i kreditorëve ishte 68,857 dhe detyrimet totale të shoqërisë ankuese ishin 32,060,884,036 lekë shqiptarë, të barabarta me 325,029,238 dollarë amerikanë. Vlerësimet e tyre u bazuan në informacionin që ishte depozituar dhe përpunuar nga grupi i mbikëqyrësve. Ato nuk u bazuan në raportin e dhënë nga shoqëria kontrolluese e caktuar nga Qeveria më 24 qershor 1998.

35. Nëpërmjet një vendimi të hollësishëm të datës 31 maj 2000 Gjykata e Rrethit e shpalli ankuesin fajtor për mashtrim dhe e dënoi atë me 5 vjet burgim. Ankuesi dhe prokurori apeluan në një datë të pacaktuar në qershor 2000.

36. Në një datë të pacaktuar në maj 2001, Gjykata e Apelit caktoi tre ekspertët e njëjtë për të bërë një raport tjetër financiar.

37. Më 17 tetor 2001 ekspertët paraqitën raportin e tyre. Sipas raportit, numri total i kreditorëve ishte 57,923 dhe detyrimi i përgjithshëm arrinte në 29,249,622,461 lekë shqiptarë, të barabartë me 199,045,000 dollarë amerikanë në atë kohë. Kjo e dhënë është marrë nga kompjuterët e shoqërisë ankuese, të cilët ishin sekuestruar nga prokuroria. Duke iu referuar numrit të pretendimeve të bëra nga kreditorët pas fillimit të procedurave të administrimit të detyruar, raporti tregonte se numri i përgjithshëm i kreditorëve ishte 38,652, ndërsa detyrimi në total ishte 127,019,677 dollarë amerikanë.

38. Për sa i përket vlerës së aseteve të shoqërisë ankuese, raporti përfundonte se, deri më 27 qershor 1997, asetet e saj arrinin në shumën 336,563,915 dollarë amerikanë. Ky vlerësim është bazuar në një vendim të Gjykatës së Rrethit të datës 27 qershor 1997, i cili rendiste pasuritë e shoqërisë dhe vlerën monetare përkatëse. Megjithatë, raporti zbriti vlerën e minierave dhe burimeve minerale¹.

39. Pas fillimit të procedurave të administrimit të detyruar vlera totale e aseteve të shoqërisë ankuese arriti në 14,683,493 dollarë amerikanë, nga të cilat 8,675,975 dollarë amerikanë përbëheshin nga të ardhurat nga shitjet e aseteve dhe 6,007,513 dollarë amerikanë ishte vlera e llogaritur e aseteve që nuk ishin shitur akoma.

40. Për sa i përket rrjedhjes së fondeve në llogaritë bankare të shoqërisë ankuese, raporti përfundonte se bilanci i saj ishte 11,533,063 dollarë amerikanë. Megjithatë, jo të gjitha bankat e përfshira kishin paraqitur raportet e rrjedhjes së fondeve. Detyrimi debitor që palët e treta i detyroheshin shoqërisë ankuese ishte llogaritur 18,453,348 dollarë amerikanë. Raporti vlerësoi dëmin e aseteve të shoqërisë ankuese si rezultat i trazirave civile të vitit 1997 në shumën 201 milionë dollarë amerikanë.

41. Më 24 dhjetor 2001 Gjykata e Apelit u bazua në fakte të njëjta të paraqitura në vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo konstatoi se ankuesi individual ishte përgjegjës për mashtrimin e 57,923 kreditorëve në shumën totale prej 29,249,622,461 lekësh shqiptarë. Gjykata shpjegoi rënien në numrin e përgjithshëm të kreditorëve dhe shumën totale të detyrimit nga zbritja e interesit të kapitalizuar dhe përjashtimi i regjistrave të pasaktë. Më

¹ Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 27 qershor 1997 vendosi të pranonte kërkesën e bërë nga shoqëria ankuese për rritjen e kapitalin të saj në shumën 797,816,311,000 lekë (përafërsisht të barabartë me 5,147,202,006 dollarë amerikanë sipas kursit të këmbimit në kohën përkatëse).

tej, gjykata rrëzoi të dhënat që rridhnin nga fakti se procedurat e administrimit të detyruar ishin të pasakta, duke pasur parasysh faktin se jo të gjithë kreditorët mund të kenë paraqitur pretendimet e tyre.

42. Gjykata e Apelit e dënoi ankuesin individual me njëzet vjet burgim në përputhje me nenin 143 § 2 të Kodit Penal, i cili kishte hyrë në fuqi më 24 janar 2001.

43. Më 22 janar 2002 ankuesi individual apeloj.

44. Më 22 nëntor 2002 Gjykata e Lartë e shpalli ankuesin individual fajtor sipas akuzës. Duke u bazuar në fakte të njëjta me ato të përshkruara në vendimet e gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë argumentoi se veprimet e ankuesit individual dhe aktivitetet e shoqërisë ankuese kishin qenë të pasakta dhe të paligjshme. Ajo la në fuqi konstatimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me numrin total të kreditorëve, pra 57,923. Megjithatë ajo përfundoi se shuma totale e detyrimeve të ankuesit ishte 22,374,141,130 lekë shqiptarë (përafërsisht 157,453,000 dollarë amerikanë në atë kohë), pasi kishte zbritur rrjedhjen e fondeve të shoqërisë, e cila arrinte në shumën 6,875,481,331 lekë shqiptarë.

45. Në marrjen e vendimit për ankuesin individual, Gjykata e Lartë arsyetoi se ai duhej të shpallej përgjegjës penalisht për një numër akuzash të njëjtë me numrin e përgjithshëm të kreditorëve, pra 57,923, në përputhje me nenin 141 § 1 të Kodit Penal, i cili parashikonte një periudhë burgimi prej 5 vjetësh. Për pasojë, ajo e dënoi ankuesin individual me njëzet vjet burgim.

46. Një përshkrim i hollësishëm i fakteve në lidhje me procedimet penale ndaj ankuesit individual mund të gjendet në çështjen Alimuçaj kundër Shqipërisë, nr.20134 § 05, komunikuar më 7 dhjetor 2009.

D. Derogimi (shmangia e përkohshme) i Shqipërisë nga detyrimet e saj sipas Konventës

47. Nëpërmjet notës verbale të datës 4 mars 1997, e cila është regjistruar pranë Sekretariatit të Përgjithshëm më 10 mars 1997, Ministria Shqiptare e Punëve të Jashtme, në përputhje me nenin 15 të Konventës, njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës mbi synimin e Qeverisë për të deroguar nga detyrimet e saj sipas Konventës. Sipas notës verbale kufizime ishin caktuar *inter alia* në të drejtën e mbledhjes, lirinë e shtypit dhe informimit, si dhe në lëvizjen e lirë të njerëzve. Asnjë kufizim nuk ishte caktuar në të drejtën për pronën.

48. Nëpërmjet notës verbale të datës 26 korrik 1997, të regjistruar pranë Sekretariatit të Përgjithshëm më 24 tetor 1997, Ministria Shqiptare e Punëve të Jashtme njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se Qeveria po tërhiqte njoftimin e saj të derogimit sipas nenit 15 të Konventës.

C. E drejta dhe praktika përkatëse vendase

1. Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese nr.7491, datë 29 prill 1991, ndryshuar me ligjin nr.8255, 19 nëntor 1997

49. Deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998, ligji për dispozitat kryesore kushtetuese ishte ligji bazë në Shqipëri. Neni 3 parashikonte ndarjen e pushteteve (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori). Neni 10, i cili parashikonte të drejtën e iniciativës ekonomike, citohet si më poshtë:

“Ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike dhe në rolin rregullues të shtetit.

Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk duhet të cenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut”.

50. Neni 11 njihte gëzimin e së drejtës së pronës.

51. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 13 nëntor 1997 (shih paragrafin 15 më lart), nenit 10 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese iu shtuan paragrafët e mëposhtëm më 19 nëntor 1997:

“Veprimtaria e kundërligjshme e subjekteve private që prek në masë interesat e individëve dhe grupeve sociale, që është në kundërvënje e në dëm të parimeve të ekonomisë së tregut e të politikave ekonomike e financiare kombëtare e ndërkombëtare, që cenon stabilitetin ekonomik e social të vendit, vihet nën kontrollin dhe administrimin e institucioneve publike kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara.

Shkalla e ndërhyrjes, si dhe kompetencat e kontrollit dhe të administrimit të këtyre subjekteve private nga ana e institucioneve të lartpërmendura, përcaktohet me ligj.

Në këto raste shteti ka të drejtë dhe detyrë të disponojë mbi pasurinë e subjekteve private vetëm në mbrojtje të interesave të të dëmtuarve.

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u ankuar në gjykatë kundër masave të kontrollit, të administrimit e të disponimit të pasurisë së tij, si dhe për të kërkuar shpërbimin e plotë të dëmeve të shkaktuara”.

Opinionit 9/1998 i Nënkomisionit mbi Reformat Kushtetuese të Komisionit Europian për Demokraci

nëpërmjet ligjit (Komisioni i Venecias) datë 15 prill 1998.

52. Më 15 prill 1998 nënkomisioni i Komisionit të Venecias mbi Reformat Kushtetuese miratoi një opinion për ndryshimet e kryera të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese më 19 nëntor 1997. Sipas opinionit, ndryshimi kushtetues *ad hoc* kishte qëllim legjitim dhe mund të kërkohej nga nevoja të përkohshme specifike. Megjithatë, opinionit deklaroi se neni i parë i amendamentit, i cili parashikonte bazën për ndërhyrjen e shtetit, përdori një numër të madh konceptesh të gjera, të cilave ishte shumë e vështirë për t'i dhënë një kuptim të saktë ligjor. Sipas opinionit, teksti *ad hoc*, i cili iu përgjigj nevojës urgjente sociale të momentit, nuk ishte i përshtatshëm si parim afatgjatë i rendit kushtetues shqiptar. Ai paralajmëroi kundër përdorimit të përsëritur të këtyre ndryshimeve kushtetuese *ad hoc* në fushën e rregullimit ekonomik dhe vlerësoi se teksti i zgjedhur nuk duhej të integrohej meqenëse ishte në Kushtetutën e ardhshme të Shqipërisë.

2. Kushtetuta e Shqipërisë

53. Kushtetuta e Shqipërisë hyri në fuqi më 28 nëntor 1998. Ajo shfuqizoi ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese siç paraqitet më lart. Dispozitat përkatëse citohen si më poshtë:

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122.

...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”.

Neni 134 §§ 1 (f) dhe 2

“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

...

f) partive politike dhe organizatave të tjera

g) individëve.

2. Subjektet e parashikuara në paragrafin e parë, shkronjat ...(f) dhe (g) mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

3. Kodi Civil

54. Neni 1050 i Kodit Civil (KC) parashikon:

“Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit”.

4. Kodi i Procedurës Civile

55. Nenet 324-333 rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

56. Neni 326, në fuqi në kohë materiale, parashikonte se asnjë padi nuk mund të ngrihet kundër akteve administrative të Qeverisë kur ato përmbajnë një detyrim të përgjithshëm, në qoftë se nuk shkelin të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve.

5. Ligji i falimentimit (ligji për procedurat e falimentimit nr.8017, datë 25 tetor 1995)

57. Ligji i falimentimit, në fuqi në kohë materiale, zbatohej për personat juridikë të cilët, si shoqëria ankuese ishin krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive. Për procedurat që duhej të filloheshin duke u bazuar në akuzën ligjore të kreditorit, ai ose ajo duhej të provonin se debitori nuk kishte përmbushur detyrimet për pagesat. Në çdo rast, debitori, gjithashtu, mund të depozitonte një akuzë të ngjashme. Procedurat e falimentimit ishin procedurat e gjykatës. Rrjedhimisht, vendimi për t'i deklaruar ato të hapura ishte në kompetencën e gjykatës së rrethit, e cila mund të vendoste debitorin në administrim të detyruar duke caktuar një administrator. Gjatë kryerjes së detyrave të tij, administratori vepronte nën mbikëqyrjen e gjykatës, e cila kishte të drejtë ta

zëvendësonte administratorin për shkaqe të bazuara dhe të arsyeshme. Ligji i falimentimit parashikonte miratimin e një plani ristrukturimi, që kërkonte aprovimin e gjykatës. Në rast se plani i ristrukturimit nuk pranohej, gjykata vendoste vazhdimin e likuidimit të menjëhershëm të aseteve të debitorit. Ligji i falimentimit parashikonte të drejtën e apelimit kundër vendimit të gjykatës së rrethit.

6. Ligji për ndalimin e skemave piramidale (ligji për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes, ligji nr.8188, datë 23 janar 1997).

58. Ligji parashikonte se huamarrja e organizuar në bazë të skemave piramidale mashtruese është veprimtari e paligjshme. Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes, përbënte shkelje ligjore dhe dënohej me jo më pak se njëzet vjet burgim dhe me konfiskim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme.

7. Ligji për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, ligji nr.8215, datë 9 maj 1997 (ligji nr.1), ndryshuar me ligjin nr.8277, datë 30 korrik 1997 (ligji nr.2), ligji nr.8256, datë 19 nëntor 1997 (ligji nr.3), ligji nr.8347, datë 18 maj 1998 (ligji nr.4) dhe ligji nr.9835 datë 22 nëntor 2007 (ligji nr.5))

a) Ligji nr.1

59. Neni 1 deklaronte se shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë a fizikë të cilët në forma dhe mënyra të ndryshme kanë marrë hua nga publiku, duhej të ishin objekt i kontrollit financiar në lidhje me pozicionin e tyre financiar, numrin e kreditorëve, me detyrimet financiare për t'u paguar, me lëvizjen e parave, si dhe me gjendjen e parave në arkë dhe depozitat në banka brenda dhe jashtë vendit, nga një grup ekspertësh financiarë të caktuar nga Qeveria në përputhje me ligjin nr.1.

60. Neni 2 krijoi një grup mbikëqyrës me tre anëtarë për të mbikëqyrur të gjithë procesin. Grupi i mbikëqyrësve bashkërendonte marrëdhëniet ndërmjet grupit të ekspertëve dhe subjekteve që i nënshtrohen ligjit nr.1 në përputhje me nenin 3 dhe i raportonte Këshillit të Ministrave.

61. Sipas nenit 4 ekspertët financiarë kontrollonin librat dhe regjistrat e shoqërisë, kontratat e lidhura me kreditorët dhe dokumente të tjera përkatëse. Neni 6 përcaktonte se raportet përfundimtare të grupit të ekspertëve i paraqiteshin organeve përkatëse shtetërore, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme.

62. Ligji nr.1 nuk parashikonte mundësinë e kontrollit gjyqësor.

b) Ligji nr.2

63. Neni 4 paraqiste objektin e ligjit nr.2. Të gjithë ata individë, persona fizikë a juridikë, të cilët kanë marrë hua nga publiku i nënshtroheshin kontrollit financiar, me përjashtim: të një banke të licencuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi; të një shoqërie, e cila emetonte letra me vlerë për investime në përputhje me legjislacionin në fuqi; të një personi fizik, i cili kishte marrë hua në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, por që të plotësonte njëkohësisht tre kushte.

64. Sipas nenit 5, Qeveria caktoi administratorët për subjektet që i nënshtroheshin kontrollit financiar. Administratorët duhej të ishin persona fizikë ose subjekte juridikë. Administratorët caktoheshin nëse plotësoheshin kushtet vijuese: a) Subjekti i kontrollit ishte në gjendjen e paaftësisë paguese, ose nëse verifikohesh se rrezikohej për t'u ndodhur në gjendjen e paaftësisë paguese; b) subjekti i kontrollit kishte pezulluar, ose ishte gati të pezullonte pagesat, apo nuk kishte mundësi të shlyente detyrimet e tij në momentin që ato duhej të përmbusheshin sipas akteve të lidhura prej tij me persona të tretë; c) veprimtaria e subjektit të kontrollit ishte në kundërshtim me parimet dhe rregullat e njohura financiare; d) gjendja në të cilën ndodhej subjekti i kontrollit ishte në kundërshtim me parimet dhe rregullat e njohura financiare; e) ishte në interes publik që subjekti i kontrollit ose personat e lidhur me të ishin subjekte të këtij ligji për shkak se kishin tërhequr në favor të tyre pasuri të personave të tretë.

65. Subjekti i kontrollit kishte të drejtë të apelonte brenda dhjetë ditëve pranë Gjykatës Kushtetuese kundër caktimit të administratorëve. Nëse Gjykata e Apelit linte në fuqi apelin, ajo urdhëronte Këshillin e Ministrave për të ndërprerë masën e administrimit të detyruar. Dhënia e vendimit të gjykatës (në rastin kur ajo prishte vendimin e Qeverisë) nuk e pengonte Qeverinë në marrjen e një vendimi tjetër për caktimin e administratorëve të tjerë në lidhje me subjektin e kontrollit, me kusht që të veprohej në përputhje me ligjin.

66. Sipas nenit 7, administratorët e caktuar nga Qeveria, *inter alia*, kishin detyrat e mëposhtme: të pezullonin tërësisht apo pjesërisht ripagimin e ndonjë huaje apo detyrimi palëve të treta; të menaxhonin veprimtarinë dhe pasurinë e subjektit të kontrollit; të ushtronin të gjitha të drejtat e aksionarit, ortakut, si dhe personelit administrativ të tyre; të shisnin apo të dispononin në mënyrë ligjore pasurinë e subjektit të kontrollit në kushtet që ai e konsideronte të arsyeshme; të konfiskonin asetet e individëve të emëruar të lidhur me skemat;

dhe të caktonin ekspertë për të zbuluar asetet jashtë vendit.

67. Neni 11 parashikonte se administratorët mund të shkarkoheshin nga pozicioni i tyre nga Qeveria sipas kushteve të caktuara. Sipas nenit 15, administratorët duhej t'i paraqisnin Qeverisë raporte të rregullta mbi ecurinë e punës.

68. Ligji nuk parashikonte mjete ligjore në dispozicion të subjekteve jobankare për të kundërshtuar veprimet e administratorëve.

c) Ligjet nr.3-5

69. Pas përfshirjes së paragrafit të ri në nenin 10 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese (shih më lart), neni 1 i ligjit nr.3 të vitit 1997 rifuti formulimin e nenit 7 të ligjit nr.2 të vitit 1997, i cili ishte prishur me vendim të Gjykatës Kushtetuese të datës 13 nëntor 1997 (shih paragrafët 15-16 më lart).

70. Neni 1 i ligjit nr.4 parashikonte se “në rastet kur shoqëritë i nënshtrohen kontrollit financiar dhe administrimit të detyruar sipas ligjit, autoritetet gjyqësore nuk dëgjojnë asnjë padi civile dhe pezullojnë të gjitha procedurat e zbatueshme në lidhje me vendimet e mëparshme të miratuara.”

71. Neni 1 i ligjit nr.5 parashikonte se grupi i mbikëqyrësve duhej t'i raportonte Ministrit të Financave.

8. Ligji për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë (ligji për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, ligji nr.8386, datë 30 korrik 1998, ndryshuar me ligjin nr.9553, datë 5 qershor 2006).

72. Neni 1 autorizonte administratorët e subjekteve ligjore jobankare të kryenin veprimet e shitjes së pasurive të këtyre subjekteve dhe pronarëve të tyre, si dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjeve të tyre. Të ardhurat do të përdorreshin për t'i siguruar publikut kompensimin monetar gjatë procesit të rishpërndarjes. Sipas nenit 3 ish-presidentët e shoqërive huamarrëse që i nënshtroheshin ligjit për kontrollin financiar të personave ligjorë jobankarë, nuk kishin të drejtë që pas shitjes së pasurisë ta riblinin atë apo të kërkonin në gjykatë të drejtën për rikthimin e saj.

73. Neni 4 përcaktonte se administratorët ishin përgjegjës për shitjen e pasurisë dhe për të vendosur për procedurat. Çmimi fillestar i shitjes përcaktohej nga një grup vlerësimi sipas nenit 9. Çdo person fizik apo subjekt ligjor, vendas ose i huaj, mund të merrte pjesë në shitjen e pasurisë në përputhje me nenin 5. Sipas nenit 6 të ligjit 1998 shitja duhej të bëhej në një nga format e parashikuara me ligj: shitje direkte, ankand ose tender publik. Sipas ligjit të vitit 2006, shitja u krye në formën e ankandit. Neni 11 i ligjit 1998 parashikoi se procesi duhej të përfundonte, në parim, para fundit të vitit 1998. Sipas ligjit të vitit 2006, pasuria që nuk ishte shitur deri më 31 dhjetor 2005 do të vihej për shitje nga Ministria e Financave.

74. Neni 14 parashikonte se vetëm ekspertët kontabël kishin të drejtë të kërkonin shpalljen e shitjes të pavlefshme nga gjykata. Kërkesa duhej të bëhej brenda 30 ditëve nga data kur ato konstatonin shkelje të dispozitave të ligjit.

9. Ligji për rishpërndarjen e pasurive të personave juridikë jobankarë (ligji për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurisë së personave juridikë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, ligji nr.8360, datë 10 qershor 1998 ndryshuar me ligjin nr.9935, datë 26 qershor 2008).

75. Neni 3 përcaktonte se shpërndarja e vlerave financiare të subjekteve jobankare duhej të bëhej sipas koeficientit të kthimit, i cili ndryshonte për çdo subjekt. Në përputhje me nenin 4, koeficienti duhej të llogaritej si raport i shumës së vlerave ekzistuese monetare në llogaritë bankare të personave juridikë jobankarë dhe të ardhurave të siguruara nga shitja e pasurisë së tyre me shumën e detyrimit debitor që personat juridikë jobankarë u kishin kreditorëve të tyre.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.52, datë 28 janar 2005

76. Më 28 janar 2005, Qeveria miratoi një vendim për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë ankuese mbi bazën e një koeficienti të caktuar. Sipas vendimit, koeficienti i shpërndarjes për kreditorët ishte llogaritur në masën njëmbëdhjetë për qind. Të ardhurat e mbledhura nga shitja e vlerave arrinin në 3,800,000,000 lekë shqiptarë (përafërsisht 26,620,100 euro). Detyrimi debitor i shoqërisë mbeti 34,361,781,170 lekë shqiptarë (përafërsisht 240,714,000 euro).

10. Ligji për detyrimet debitore (ligji për nxjerrjen e detyrimeve debitore dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë nr.8471, datë 8 prill 1999).

77. Neni 4 parashikonte se administratorët duhej të identifikonin të gjithë personat fizikë e juridikë që kishin detyrime debitore ndaj personave jobankarë subjekt i ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë. Sipas nenit 5 administratorët duhej të miratonin një vendim për personat që do të deklaroheshin

debitorë dhe vlerat financiare dhe pasurore debitorë që ato duhej të kthenin në llogaritë bankare të personave juridikë jobankarë. Ky vendim përbënte një titull ekzekutiv dhe ishte i zbatueshëm. Neni 7 i lejonte debitorëve 45 ditë afat nga data e njoftimit të vendimit të administratorëve për të përmbushur detyrimet e tyre; dështimi i debitorëve për të përmbushur detyrimin, rezultonte në ekzekutimin e detyrueshëm nga zyra e përbarimit.

78. Sipas nenit 8, pala e dëmtuar kishte të drejtën të kundërshtonte vendimin e administratorëve dhe veprimet e zyrës së përbarimit para Gjykatës së Apelit respektivisht brenda dhjetë dhe pesë ditëve.

Vendimi i administratorëve nr.30, datë 31 gusht 1999

79. Më 31 gusht 1999 administratorët e shoqërisë ankuese miratuan një vendim në lidhje me emrat e debitorëve të shoqërisë. Vendimit iu shtua një listë me emrat e 25 debitorëve dhe detyrimet e tyre debitorë përkatëse. Në listë përfshihej emri i ankuesit individual me një detyrim debitor në shumën 171,924,300 lekë shqiptarë (përafërsisht 1,204,380 euro).

ANKIMI

80. Ankuesit u ankuan sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës për ndërhyrjen e pajustificuar të shtetit në gëzimin paqësor të zotërimeve të tyre dhe shmangien e gjyqësorit në mbikëqyrjen e veprimeve të shtetit.

E DREJTA

81. Ankuesit u ankuan për shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

A. Parashtrimet e palëve

1. Qeveria

82. Qeveria argumentoi se, meqenëse shoqëria ankuese ishte në administrim, as shoqëria dhe as ankuesi nuk mund të pretendonin se ishin “viktimë” në kuptim të nenit 34 të Konventës. Për më tepër, ankuesi individual kishte detyrime ndaj kompanisë.

83. Sipas mendimit të Qeverisë, ankuesi individual nuk kishte kundërshtuar vendimin e Qeverisë të datës 28 tetor 1997 (*shih paragrafin 12 më lart*). Akuza e tij kundër vendimit të datës 22 korrik 1997 kishte provuar se ishte efektive për këtë qëllim. Për më tepër, ai nuk kishte kundërshtuar të njëjtin vendim në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Civile, dhe as nuk kishte depozituar ankim kushtetues në përputhje me ligjin e Gjykatës Kushtetuese. Nëse do të kishte vepruar kështu, gjykatat vendase do të kishin miratuar një vendim për ligjshmërinë e ndërhyrjes së shtetit. Për arsyet e mësipërme, Qeveria vlerësoi se ankimi ishte parashtruar jashtë afatit gjashtëmujor.

84. Qeveria parashtrroi se shoqëria ankuese nuk kishte zotërime ekzistuese në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Sipas mendimit të saj, neni 1 i protokollit nr.1 mbron të drejtën e pronës në lidhje me asetet që rridhnin nga të drejtat legjitime të individëve dhe jo asetet e prokuruar në mënyrë të paligjshme duke u bazuar në përvetësimin e padrejtë të të tjerëve. Pjesa më e madhe e aseteve të shoqërisë ishte krijuar duke u bazuar në paratë e marra hua nga kreditorët duke pasur parasysh se shoqëria nuk funksiononte me përfitim.

2. Ankuesit

85. Ankuesit parashtruan se çdo përpjekje për të kundërshtuar vendimin e Qeverisë të datës 28 tetor 1997 do të ishte e paefektshme duke pasur parasysh zëvendësimin e gjyqësorit nga Qeveria në vënien e shoqërisë ankuese në administrim të detyruar. Ato theksuan vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 17 shtator 1997, të cilin Qeveria nuk e kishte marrë parasysh duke caktuar të njëjtët administratorë, në kundërshtim me konstatimet e gjykatës. Për më tepër, aktet ligjore në fuqi, nuk i ngarkonin administratorët me përgjegjësi për ndonjë dëm të pariparueshëm shkaktuar shoqërisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

86. Ankuesit deklaruan se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 13 nëntor 1997 në favor të tyre nuk ishte respektuar nga Qeveria. Gjashtë ditë pas vendimit të gjykatës, Qeveria kishte ndryshuar ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese dhe kishte rifutur të njëjtën dispozitë që ishte deklaruar jokushtetuese nga ajo gjykatë. Prandaj ankuesit pretenduan se veprimet e Qeverisë dhe legjislacioni i kishin bërë mjetet ligjore vendase të paefektshme.

87. Për sa i përket raportit të administratorëve të datës 31 janar 1998 dhe raportit të kontrollit financiar të datës 5 janar 1999, ankuesit deklaruan se ato nuk ishin njoftuar për përmbajtjen e tyre deri në konstatimet e komisionit hetimor parlamentar të vitit 2003. Edhe nëse ato do të njoftoheshin dhe do të kundërshtonin këto konstatime, përsëri nuk do të kishin një perspektivë të arsyeshme për sukses.

88. Më tej, ankuesit parashtruan se, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, ato kishin kundërshtuar në mënyrë

të pasuksesshme kushtetutshmërinë e ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë dhe ligjit për shitjen e pasurisë së personave juridikë jobankarë.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Papajtueshmëria e pretenduar *ratione personae* dhe *ratione materiae*

89. Gjykata përsërit se termi “viktimë” në nenin 34 të Konventës tregon personin e prekur drejtpërdrejt nga ligji apo mosveprimi i tij për çështjen në shqyrtim (*shih Eckle kundër Gjermanisë, 15 korrik 1982, § 66, seria A nr.51*). Në vendimin e saj Agrotexim dhe të tjerë kundër Greqisë (24 tetor 1995 § 66, seria A nr.330-A), Gjykata argumentoi se, në parim, një shoqëri duhej t’i drejtohej institucioneve të Konventës nëpërmjet organeve të saj ligjore ose, në rastin e likuidimit, nëpërmjet likuiduesve të saj. Vetëm në rrethana të veçanta, veçanërisht kur përcaktohej qartë se ishte e pamundur që shoqëria të drejtohej nëpërmjet likuiduesve të saj, atëherë ankimi mund të depozitohet në emër të saj nga të tjerë, për shembull nga aksionarët e saj, me kusht që të jenë prekur të drejtat e tyre individuale.

90. Gjykata me tej përsërit se Konventa dhe protokollet e saj duhet të interpretohen se garantojnë të drejtat që janë praktike dhe efektive në kundërshtim me ato teorike dhe iluzive. Ky parim është, gjithashtu, i zbatueshëm për nenin 34 të Konventës, i cili u jep individëve dhe organizatave joqeveritare të drejtën e natyrës procedurale (*shih Banka Kapitale AD kundër Bullgarisë (dec.)*, nr.49429/99, 9 shtator 2004, dhe *Banka Industriale dhe e Kreditit kundër Republikës Çeke*, nr.29010/95, § 48, GJEDNJ 2003-XI (ekstrakte)).

91. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, kur është depozituar ankimi para saj më 2 qershor 2005, shoqëria ankuese ishte vënë tashmë në administrim të detyruar. Prandaj, administratorët kishin të drejtë t’i drejtoheshin Gjykatës në emër të shoqërisë ankuese nëse ato e konsideronin me vend. Megjithatë ankimi para Gjykatës lidhet saktësisht me ngjarjet komplekse që shpjen në caktimin e administratorëve, rolin e tyre dhe kryerjen e procedurave të administrimit të detyruar. Ankimi nuk lidhet me ndërhyrjen e pretenduar në të drejtën e pronës të shoqërisë ankuese, të cilën administratorët ishin caktuar të mbrojnë dhe menaxhojnë dhe në lidhje me të cilën administratorët mund t’i drejtoheshin institucioneve të Konventës në emër të shoqërisë ankuese.

92. Prandaj ekziston një konflikt i qartë interesi ndërmjet shoqërisë ankuese dhe administratorëve në lidhje me ankimin para Gjykatës, duke qenë e pamundur që shoqëria ankuese t’i drejtohej Gjykatës nëpërmjet tyre (*shih Camberrow MM5 AD kundër Bullgarisë (dec.)*, nr.50357/99, 1 prill 2004, dhe *Roseltrans, Finlease dhe Myshkin kundër Rusisë (dec.)*, nr.60974/00, 27 maj 2004). Të argumentosh se vetëm administratorët ishin të autorizuar të përfaqësonin shoqërinë ankuese në depozitimin e ankesave të tilla para Gjykatës, do të thotë të bësh teorike dhe iluzive të drejtën e petitionit individual dhënë nga neni 34 (*shih Banka Industriale dhe e Kreditit, cituar më lart § 51*).

93. Gjykata thekson se ankuesi individual ishte aksionari i vetëm i shoqërisë ankuese që nga themelimi i saj në vitin 1992. Aksionet e ankuesit padyshim kishin vlerë ekonomike dhe përbënin “zotërimi” në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1 (*shih Marini kundër Shqipërisë, nr.3738/02, § 164, GJEDNJ 2007-XIV (ekstrakte)*, dhe *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës (dec.)*, nr.48553/99, 27 shtator 2001). Ankuesi individual e kryente biznesin e tij nëpërmjet shoqërisë dhe për rrjedhojë kishte interes direkt personal në objektin e ankimit (*shih G.J kundër Luksemburgut, nr.21156/93 § 24, 26 tetor 2000*). Të argumentosh se ankuesi individual nuk kishte zotërimi ekzistues në kohën e paraqitjes së ankimit do të thotë të dëmtosh vetë thelbin e të drejtës së ankimit individual, meqenëse do të nxiste qeveritë të privonin këta individë nga e drejta e pronës së tyre dhe, në të njëjtën kohë, nga mundësia për t’u ankuar për këtë çështje pranë Gjykatës.

94. Rrjedhimisht Gjykata konstaton se, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankimeve të bëra, ekzistonin rrethana të veçanta të cilat i jepnin të drejtën ankuesit individual, i cili ishte presidenti dhe aksionari i vetëm i shoqërisë ankuese dhe kishte “zotërimi”, të depozitonte një ankim të vlefshëm në emër të tij dhe të shoqërisë ankuese.

95. Kundërshtimet e Qeverisë në lidhje me papajtueshmërinë *ratione personae* dhe *ratione materiae* duhet të rrëzohen.

2. Mosshterimi i pretenduar i mjeteve ligjore vendase

96. Gjykata përsërit se rregulli i shterimit të mjeteve ligjore vendase referuar në nenin 35 të Konventës detyron të gjithë personat që paraqesin çështjet e tyre kundër shtetit para Gjykatës të përdorin së pari mjetet ligjore të siguruara nga sistemi ligjor kombëtar (*shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, seria A nr.24*). Rekursi duhej të bëhej nga një ankues me mjete ligjore që janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të gjetur zgjidhje në lidhje me shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve ligjore në fjalë duhet që të jetë e sigurt në mënyrë të mjaftueshme jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pasi dështimi në përdorimin

e tyre, sjell mungesën e aksesibilitetit dhe efektivitetit të nevojshëm (*shih Aksoy kundër Turqisë, 18 dhjetor 1996, § 51, raporte dhe vendime 1996-VI*). Një ankues nuk mund të konsiderohet se ka dështuar të sherojë mjetet ligjore vendase nëse ai ose ajo mund të tregojë, duke paraqitur praktikën ligjore përkatëse vendase apo ndonjë të dhënë tjetër të përshtatshme, se një mjet ligjor në dispozicion të cilin ai ose ajo nuk e ka përdorur, ishte i detyruar të dështonte (*shih Kleyn dhe të tjerë kundër Holandës [GC] nr.39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, § 156, GJEDNJ 2003-VI*).

97. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në një datë të pacaktuar në vitin 1997 shoqëria ankuese kundërshtoi vendimin e Qeverisë të datës 22 gusht 1997. Më 17 shtator 1997 Gjykata e Apelit prishi vendimin për mospërputhje me të drejtën vendase. Më 28 tetor 1997 Qeveria caktoi të njëjtët administratorë me të njëjtat kushte që prishi Gjykata e Apelit. Shoqëria ankuese nuk apeloj kundër vendimit.

98. Për sa i përket kompetencave të administratorëve, Gjykata vëren se në vitin 1997 ankuesi individual kundërshtoi kushtetutshmërinë e nenit 7 të ligjit nr.2. Më 13 nëntor 1997 Gjykata Kushtetuese e shpalli këtë nen jokushtetues. Më 19 nëntor 1997, ligji nr.3 rifuti në mënyrë efektive të njëjtin formulim që ishte konstatuar jokushtetues, pas një shtese bërë ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese i cili futi të drejtën e shtetit për të kontrolluar dhe administruar pronën e subjekteve private si ajo e shoqërisë ankuese.

99. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nëse akuzat para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Kushtetuese ishin, në parim, mjete ligjore për t'u shteruar, efektiviteti i tyre është bërë i pavlefshëm nga veprimet e autoriteteve. Prandaj, asnjë nga ankuesit nuk është kërkuar të bëjë rekurs të mëtejshëm me një mjet ligjor, i cili, nëse do të rezultonte i suksesshëm, ka shumë të ngjarë që do të pengohej nga veprimet e autoriteteve.

100. Për më tepër, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së re në vitin 1998, më 17 janar 1999 shoqëria ankuese u përpoq të kundërshtonte kushtetutshmërinë e ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë dhe ligjit për shitjen e pasurisë së personave juridikë jobankarë. Megjithatë, kundërshtimi i tij nuk mund të përmbushej, me sa duket për mungesë legjitimitimi sipas Kushtetutës së re (*shih paragrafin 27 më lart*). Gjykata, gjithashtu, përsërit se nëse më shumë se një mjet ligjor efektiv është në dispozicion, ankuesit i kërkohet të përdorë vetëm njërin prej tyre. Në fakt, kur përdoret një mjet ligjor, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër ligjor i cili në thelb ka të njëjtin qëllim (*shih Micallef kundër Maltës [GC], nr.17056/06, § 58, GJEDNJ 2009-..., dhe Kozacioğlu kundër Turqisë, nr.2334/03, § 40, 31 korrik 2007*). Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se ankuesve nuk u është kërkuar të sherojnë asnjë mjet tjetër ligjor në dispozicion siç pretendohet nga Qeveria.

101. Duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se ky kundërshtim duhet të rrëzohet.

3. Afati gjashtëmujor

102. Sipas nenit 35 § 1 të Konventës Gjykata “mund të merret me një çështje...brenda një periudhe gjashtëmujore nga data kur është marrë vendimi përfundimtar”. Neni 35 § 1 i referohet “vendimit përfundimtar” të marrë në procesin e shterimit të mjeteve ligjore vendase të cilat janë “efektive dhe të mjaftueshme” për të zgjidhur ankimin e ankuesit. Megjithatë në rastet kur që në fillim është e qartë se asnjë mjet ligjor efektiv nuk është në dispozicion të ankuesit afati shtrihet nga data e ankimit ndaj ligjeve dhe masave ose nga data e marrjes dijeni të ligjit apo efektit të tij ose dëmit të ankuesit. Kur një ankues përdor një mjet ligjor ekzistues dhe vetëm më pas bëhet i ndërgjegjshëm për rrethanat që e bëjnë këtë mjet ligjor të paefektshëm, mund të jetë me vend për qëllime të nenit 35 § 1 që të merret si fillim i periudhës gjashtëmujore data kur për herë të parë ankuesi u bë ose duhej të bëhej i ndërgjegjshëm për këto rrethana (*shih Kolu kundër Finlandës (dec.), nr.56463/10, 3 maj 2011; Varnava dhe të tjerë kundër Turqisë [GC], nr.16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, § 157, GJEDNJ 2009-...; Dennis dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr.76573/01, 2 korrik 2002; dhe Paul dhe Aubrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr.46477/99, 4 qershor 2001*).

103. Në rastin konkret Gjykata vëren se ankuesit përdorën në mënyrë të suksesshme mjetet ligjore vendase të paktën në dy raste. Efektiviteti i këtyre mjeteve ligjore është dëmtuar nga veprimet vijuese të Qeverisë (*shih paragrafët 97-98 më lart*). Në një rast të tretë, kërkesa kushtetuese e ankuesit në Gjykatën Kushtetuese është shpallur e papranueshme më 17 janar 1999 (*shih paragrafin 100 më lart*). Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se më së shumti më 17 janar 1999 ankuesit u bënë të ndërgjegjshëm se nuk kishte asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion të tyre në lidhje me ankimin sipas nenit 1 të protokollit nr.1. Pra, ato duhej të kishin paraqitur ankimin e tyre brenda gjashtë muajve nga data e mësipërme. Megjithatë, ankimi i tyre është depozituar më 2 janar 2005.

104. Gjykata më tej thekson se afati gjashtëmujor nuk zbatohet si i tillë në situatat e mëtejshme (*shih,*

për shembull, Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.609/07, § 24, 20 korrik 2010).

Kjo ndodh sepse, nëse ka një situatë me shkelje të vazhdueshme, në të vërtetë afati fillon përsëri çdo ditë dhe vetëm kur ndërpritet situata, atëherë përfundon periudha përfundimtare prej gjashtë muajsh (*shih, Varnava dhe të tjerë, cituar më lart, §§ 158-159*).

105. Në praktikën e saj ligjore Gjykata ka vlerësuar se ka pasur “situata të vazhdueshme” që e paraqisnin çështjen brenda kompetencës së saj në lidhje me nenin 35 § 1 ku, *inter alia*, kishte raste të njëpasnjëshme përkatëse të cilat vazhdonin në kohën e paraqitjes së ankimit ose përfundonin më herët se gjashtë muaj para saj (*shih, për shembull, Vladimirova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, nr.42617/02, §§ 29-30, 26 shkurt 2009*) ose ku një dispozitë ligjore shkaktonte gjendje të pandryshueshme të çështjeve në formën e një kufizimi të qëndrueshëm mbi të drejtën individuale të mbrojtur nga Konventa, siç është e drejta për të votuar ose kandiduar për zgjedhje (*shih Paksas kundër Lithuanisë [GC], nr.34932/04, § 83, 6 janar 2011, me referenca të mëtejshme*).

106. Gjykata nuk përcakton nëse ankimi i ankuesve ka të bëjë me shkelje të vazhdueshme të Konventës nga shteti dhe për rrjedhojë është parashtruar në kohën e duhur ose nëse ka të bëjë me një ligj apo situatë që ka mbaruar më vonë se gjashtë muaj para datës së paraqitjes së ankimit të tyre.

107. Ankuesit ankohen sipas nenit 1 të protokollit nr.1 se legjislacioni në fuqi dhe veprimet e autoriteteve në lidhje me caktimin e administrimit të detyruar, kryerja e administrimit të detyruar, si dhe shitja dhe likuidimi i pasurive të tyre, rezultonte në privimin e së drejtës së pronës dhe në mohimin e së drejtës për akses në drejtësi.

108. Është e qartë nga faktet e çështjes se ndërhyrja e shtetit dhe ndërhyrja në gëzimin paqësor të ankuesve të pronës së tyre filloi, pas miratimit të ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë më 9 maj 1997. Masa legjislative të njëpasnjëshme hynë në fuqi, veçanërisht ligji për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë i vitit 1998, ligji për rishpërndarjen e pasurive të personave juridikë jobankarë i vitit 1998, si dhe ligji për detyrimet debitore i vitit 1999.

109. Gjykata vëren se miratimi i ligjeve të mësipërme, i cili arriti kulmin në vitin 1999 synonte veçanërisht personat jobankarë siç është rasti konkret i shoqërisë ankuese. Ato përbënin ligje të menjëhershme, të vetme, që ndodhnin në momente të veçanta kohore (*shih Posti dhe Rahko kundër Finlandës nr.27824/95, § 40, GJEDNJ 2002-VII; Petkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë (dec.), nr.77568/01, 178/02, dhe 505/02, 4 dhjetor 2007; dhe Meltex LTD kundër Armenisë (dec.), nr.37780/02, 28 maj 2008*). Ndryshimet e ligjeve të mësipërme, duke përfshirë vendimet e administratorëve dhe vendimet e Këshillit të Ministrave, ishin pasojë e tyre. Fakti që administrimi i detyruar vazhdon aktualisht, nuk shkakton gjendje të pandryshueshme të çështjeve, por është tregues i efekteve të qëndrueshme të masave dhe ligjeve të fundit legjislative.

110. Në këto rrethana veprimet e autoriteteve nuk përbëjnë shkelje të vazhdueshme të së drejtës së ankuesve. Në qoftë se, siç pretendojnë ankuesit, ato nuk janë bërë të ndërgjegjshëm për situatën deri në miratimin e raportit parlamentar të vitit 2003, gjithsesi ato nuk kanë vepruar në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 35 § 1 të Konventës.

111. Prandaj Gjykata përfundon se ankimi duhet të rrëzohet meqenëse është jashtë afatit në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

Deklaron ankimin të papranueshëm.

ZËVENDËS REGJISTRUES
Fatoş Araci

KRYETAR
Nicolas Bratza